



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 19.09.2025
Numër Protokolli: 6515/2025

A.nr.1473/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare e kolegjit, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtarë të kolegjit, me Kaltrina Avdullahi Prenaj, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1473/2025, të datës 25.07.2025, të parashtruar nga ankuesi D.R, kundër organit të punësimit: Ministrisë së Punëve të Brendshme, në çështjen juridike “*transferim i përhershëm*”, në mbështetje të nenit 6, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenit 16, paragrafi 3 dhe nenit 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të datës 19.09.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si bazuar ankesa me numër A.nr.1473/2025, të datës 25.07.2025, e parashtruar nga ankuesi D.R. **Anulohet si i paligjshëm** Vendimi me Nr.1127/2025, i datës 11.07.2025, i Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Punëve të Brendshme, lidhur me transferimin e përhershëm të ankuesit nga pozita Zyrtar për Rrjetet, pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, në pozitën Asistent Administrativ në Qendrën për Pjisje me Dokumente, Drejtoria për Pajisje me Dokumente në Pejë-Agjencia e Regjistrimit Civil.

II. Obligohet Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Punëve të Brendshme që në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të vendimit, të ndërmerret të gjitha veprimet e nevojshme ligjore në mënyrë që sistemi i ankuesit për shkak të ristrukturimit, të behët në pajtim të plotë në dispozitat ligjore në fuqi si dhe duke ndjekur pikëpamjet juridike si në arsyetim të këtij vendimi.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim për veprimet e ndërmarra.

A r s y e t i m

Ankuesi D.R (*referuar tutje vetëm ankuesi*), më datë 22.07.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit Nr.1127/2025, të datës 11.07.2025, të Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka procedura kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Ministrinë e Punëve të Brendshme, ndërsa, kjo e fundit më datë 12.09.2025 përmes emailit ka dërguar përgjigjen në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 5085/2025 të datës 25.07.2024 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr.1127/2025 të datës 11.07.2025 për transferimin e ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë; Përgjigjen në ankesë e datës 12.09.2025 së bashku me dokumentet e dorëzuara nga organi i punësimit; Përgatitja Profesionale (Diploma e Ankuesit); Kërkesën për zbatimin e vendimeve të qeverisë nga Drejtori i Departamentit të Buxhetit i MF për Ministrinë Financave datës 03.05.2016; Vendimin me Nr. 065/142 të datës 19.04.2017 të Qeverisë së Republikës së Kosovës; Akt emërimit të datës 11.01.2016; Listat e pagave për ankuesin Janar, Shkurt, Mars, Prill, Maj Qershor dhe Korrik 2025; Vendimin me numër protokolli 6014/2025 të datës 08.09.2025 për vazhdimin e afatit të vendosjes së ankesës së ankuesit.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së ankesa e ankuesit është e bazuar, **sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës rrjedhë së ankuesi sipas Akt Emërimit të datës 11.01.2016 është i emëruar në pozitën Zyrtar për Rrjete, ndërsa, Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Punëve të Brendshme me Vendimin me numër Nr.1127/2025, të datës 11.07.2025, ka transferuar ankuesin në mënyrë të përhershme nga pozita Zyrtar për Rrjete, në pozitën Asistent Administrativ në Qendrën për Pajisje me Dokumente, Drejtoria për Pajisje me Dokumente në Pejë-Agjencia e Regjistrimit Civil.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundërshton ligjshmërinë e Vendimit me Nr.1127/2025, të datës 11.07.2025, duke pretenduar se transferimi është bërë në kundërshtim me dispozitat ligjore.

Ministria e Punëve të Brendshme në përgjigjen në ankesë të datës 12.09.2025, lidhur me ankesën A.nr. 1249/2025 si dhe sqarimin e dhënë më datë 30.09.2025, ka pohuar se: *...Më marrëveshjen e Brukselit të vitit 2015 mes Kosovës dhe Serbisë, ndërmjetësuar nga komuniteti ndërkombëtar, për shpërbërjen e ashtuquajturës "Mbrotjtje Civile" dhe integrimin e ish personelit të saj në institucionet civile të Republikës së Kosovës, MPB ka pranuar një numër serbesh për ti integruar në institucionet e Kosovës. Në mesin e tyre janë edhe 10 serbë.... të pranuar në ish Ministrinë e Administratës Publike, tash Ministria e Punëve të Brendshme. Ne mesin e këtyre nëpunësve është edhe D.R në pozitën e punës Zyrtar i Rrjetit, sipas akt emërimit të datës 11.01.2016. Me Rregulloren (ZKM) Nr. 01/2021 për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Vendeve të Punës në Ministrinë e Punëve të Brendshme si dhe me Rregullores (ZKM) Nr. 03/2023 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (ZKM) Nr. 01/2021 për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Vendeve të Punës në Ministrinë e Punëve të Brendshme, pozita që mban ankuesi nuk ekziston. Andaj me qëllim të sistemit të tij, me Vendimit me nr. 1127 të datës 11.07.2025 ankuesi transferohet në pozitën Asistent Administrativ në Qendrën e Regjistrimit të Autoimjeteve, Drejtoria për Regjistrimin e Dokumenteve në Pejë-Agjencia e Regjistrimit Civil. Transferimi i tij është bërë brenda kategorisë...Pasi i është shuar pozita z. V., ky transferim është i domosdoshëm pasi asnjë zyrtar nuk mund të gëzoj pagë pa vijuar punën.... Kërkon që ankesa të hedhet poshtë dhe vendimi me Nr.1127/2025 i datës 11.07.2025 të mbetet në fuqi...*

Lidhur me ligjshmërinë e aktit të kontestuar me ankesë, Kolegji i Këshillit, iu referua Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, me theks të veçantë:

-Nenit 65: *"1. Nëpunësja/i civil mund të transferohet për interes të institucionit në mënyrë të përhershme në vend tjetër të punës për ushtrimin e funksioneve të njëjta ose të ndryshme, në të njëjtën kategori të shërbimit civil. Për rastet kur nëpunësja/i civil është e nivelit drejtues të ulët, mesëm apo të lartë, transferimi sipas këtij neni bëhet për periudhën e mbetur të mandatit për të cilin është*

emëruar. 2. Transferimi i përhershëm mund të bëhet në një njësi tjetër administrative në kuadër të institucionit të njëjtë ose në institucion tjetër të shërbimit civil. 3. Përgatitja profesionale e nëpunës/it që transferohet duhet të jetë në përputhje me kërkesat e pozitës në të cilën transferohet. 4. Transferimi i nëpunës/it civil brenda institucionit të njëjtë bëhet në pajtim me udhëheqësen/in e drejtpërdrejtë, udhëheqësen/in më të lartë administrativ dhe me pëlqimin e nëpunës/it civil. 5. Transferimi i nëpunës/it civil në një institucion tjetër të shërbimit civil, bëhet në pajtim me pëlqimin e nëpunës/it dhe me marrëveshje në mes të institucioneve. 6. Refuzimi për transferimin e përhershëm mund të bëhet vetëm në këto raste: 6.1. kur gjendja e saj/tij shëndetësore, dëshmuar me vërtetim mjekësor e pamundëson transferimin; 6.2. nëse vendi ku do të transferohet gjendet më shumë se njëqind (100) km nga vendbanimi i nëpunës/it civil; 6.3. për arsye objektive të dëshmuar që e pamundëson transferimin. 7. Qeveria me akt nënligjor, me propozim të ministrisë përgjegjëse për administratë publike miraton rregullat për zbatimin e këtij neni...

-Nenit 66: 1. Nëse për shkak të shuarjes apo ristrukturimit të institucionit, pozita e mëparshme e një nëpunëse/i civil shuhet, ajo/ai mund të transferohet në një pozitë tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori. 2. Transferimi, sipas paragrafit 1. të këtij neni, mund të bëhet: 2.1. në të njëjtin institucion; 2.2. në institucionin që është bashkuar institucioni i shuar, në institucionin që është ndarë apo në institucionin që ka marrë funksionet që kryente më parë nëpunësja/i; 2.3. në agjencinë ekzekutive të institucionit të ristrukturuar; 2.4. në një institucion tjetër të shërbimit civil. 3. Në çdo rast shuarje apo ristrukturimi të institucionit krijohet komisioni i ristrukturimit që shqyrton mundësitë e sistemit të çdo nëpunëse/i civil në vendet e lira ekzistuese dhe propozon transferimin e nëpunës/it në një pozitë të lirë, për të cilën i plotëson kërkesat e vendit të punës. 4. Vendimi përfundimtar i transferimit merret nga njësia përgjegjëse në bazë të propozimit të komisionit. 5. Nëpunësja/i mund të refuzojë transferimin vetëm për arsyet e parashikuara në paragrafin 3. të nenit 63 të këtij ligji. Refuzimi i transferimit për arsye të tjera, përbën shkak për lirim nga shërbimi civil. 6. Komisioni i ristrukturimit, i parashikuar në paragrafin 3. të këtij neni, drejtohet nga njësia përgjegjëse dhe në të bëjnë pjesë përfaqësues të institucioneve të parashikuara në nën-paragrafët 2.1., 2.2., 2.3. apo 2.4. të këtij neni, sipas rastit ku bëhet ristrukturimi përkatës...

Referuar kuadrin ligjor, Kolegji ka analizuar aktin e atakuar më ankesë në ndërlidhje me provat materiale të çështjes ankimore dhe si rrjedhojë Kolegji konstaton se baza ligjore dhe procedura mbi të cilën është nxjerr Vendimi Nr.1127/2025, i datës 11.07.2025, i Sekretares së Përgjithshme të MPB-së, janë në kundërshtim të plotë me arsyet e transferimit të ankuesit, për faktin se transferimi i ankuesit ka qenë si pasojë e shuarjes së pozitës së tij më Rregulloren (ZKM) Nr. 01/2021 për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Punëve të Brendshme, e plotësuar dhe e ndryshuar më Rregulloren (ZKM) Nr. 03/2023. Rrjedhimisht, duke qenë se pozita e ankuesit është shuar, atëherë, për sistemin e ankuesit duhej të aplikohet procedura e përcaktuar më nenin 66 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, e jo procedura e transferimit të përhershëm (sipas nenit 65 të këtij ligji) procedurë kjo e fundit që vejnë në shprehje dhe rrjedhimisht aplikohet në rrethana dhe kushte tjera ligjore.

Pra, duke qenë se në rastin konkret kemi të bëjmë me transferim të ankuesit për shkak të ristrukturimit të institucionit përkatës, gjegjësisht, pozita e ankuesit është shuar, rrjedhe fakti se Ministri e Punëve të Brendshme më hyrjen në fuqi të Rregullores (ZKM) Nr. 01/2021 për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Punëve të Brendshme, është dashur që sipas kërkesave ligjore të parapara me nenin 54 në Ligjit Nr.06/ - 114 Për Zyrtarët Publikë, i aplikueshëm në atë periudhë, të bëjë sistemin e të punësuarve në këtë institucion, e po ashtu, pa vonesë, më hyrjen në fuqi të Rregullores (ZKM) Nr. 03/2023 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (ZKM) Nr. 01/2021, Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Punëve të Brendshme, ka qenë e obliguar që sipas nenit 66 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë(në fuqi), fillimisht të themeloj Komisionin e ristrukturimit i cili përgatit propozimet për transferim të çdo zyrtari, ndërsa,

Njësia e personelit me vendim veç e veç sistemon të gjithë nëpunësit publikë në pozitat e propozuara, veprime këto që nuk janë ndërmarr në rastin konkret.

Si rrjedhojë, nisur nga konstatimi si më sipër, vendimi Nr.1127/2025 i datës 11.07.2025, për transferimin e përhershëm të ankuesit është vendim i nxjerr në kundërshtim të plotë me dispozitat procedurale dhe materiale dhe mbi ketë shkak, akti i kundërshtuar është i paligjshme në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafet 1.4 dhe 1.5 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që, më qëllim të kthimit të ligjshmërisë, Kolegji aprovoj ankesën e ankuesit si të bazuar, anuloi Vendimin Nr.1127/2025 të datës 11.07.2025, të Sekretares së Përgjithshme të MPB-së, më detyrimin që kjo e fundit, ankuesin ta kthejë fillimisht në vendim e tij të punës sipas akt emërimit të datës 11.01.2016 dhe vetëm në pajtim me dispozita ligjore në fuqi të bëjë sistemin e zyrtareve publikë për shkak të ristrukturimit, përfshirë edhe ankuesin.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda A.nr.1473/2025

Kaltrina Avdullahi Prenaj

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj Demi

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit D.R;
- Organit të punësimit: Sekretares së Përgjithshme dhe Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në MPB;
- Arkivit të KPMSHCK-së.